

“LIRI, SHPRESË APO
ZHGËNJIM”: VERIU I KOSOVËS
DREJT RIKTHIMIT NËN
UDHËHEQJEN E SERBËVE

FAQE 4



Banorët serbë të komunave veriore të Kosovës janë të ndarë mes shpresës dhe

skepticizmit për zgjedhjet e 12 tetorit: disa e presin rikthimin e serbëve në krye të

komunave si “liri”, ndërsa të tjerët nuk presin ndryshime të mëdha

FONDI I SIGURISË PËR USHTRINË NUK ËSHTË KLASIFIKUAR KURRË NGA MINISTRIA E FINANCAVE

F.3



OSMANI AKUZON VUÇIQIN SE TENTOI TA PRISHTE TAKIMIN E BËRDO-BRIONIT: DO TË VAZHDOJMË TA FUQIZOJMË USHTRINË TONË

F.2



AKTUALE



KRYEMINISTRI I FRANCËS LECORNU JEP DORËHEQJE VETËM NJË MUAJ PASI U EMËRUA

F.2

BELGJIKA SYNON MARRËVESHJE ME KOSOVËN DHE SHQIPËRINË PËR BURGJE

F.6

EKSPERTI MJEKOLIGJOR I THOTË GJYKATËS SË LIRIDONA ADEMAJ U VRA NGA NJË LARGËSI PREJ 2 DERI NË 5 CENTIMETRA

F.7

EKONOMI



Reagim i KMDLNj-së

PSE KAO SHUMË REDUKTIME ME RRYMË?! F.8

LIDHJA E BIZNESEVE: PËR INATE POLITIKE PO DËMTOHET EKONOMIA E VENDIT, MBI 1 MILIARD EURO TË BLLOKUARA NË KUVEND

F.8

SPORT



FRANCO FODA, OPTIMIST PARA NDESHJEVE ME SLLOVENINË DHE SUE DINË

F.11

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

OSMANI AKUZON VUÇIQIN SE TENTOI TA PRISHTE TAKIMIN E BËRDO-BRIONIT: DO TË VAZHDOJMË TA FUQIZOJMË USHTRINË TONË

DURRËS, 6 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, akuzoi presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, se tentoi “të prishte takimin” e Bërdo-Brionit që u mbajt të hënën në Durrës, por shtoi se në fund udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor me unanimitet miratuan një deklaratë të përbashkët të samitit.

Pas samitit, Osmani tha për transmetuesin publik shqiptar se Vuçiq, iu drejtua samitit me “ofendime dhe arrogancë”. “...natyrisht që për çdo propagandë që Vuçiqi synonte të prezantonte para pjesëmarrësve, ne si Republikë e Kosovës kishim argumentet tona të fuqishme, argumente në anën e së drejtës dhe argumente të cilat janë fuqizuar e mbështetur edhe nga e drejta ndërkombëtare, nëpërmjet mendimeve të GJND-së”, tha Osmani, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që vendosi se me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 2008 nuk ishte shkelur ligjin ndërkombëtar.

Serbia refuzon ta pranojë pavarësinë e Kosovës dhe e konsideron shtetin pjesë të saj. Gjatë samitit, sipas Osmanit, Vuçiq u ankua edhe për marrëveshjen në fushën e mbrojtjes që Kosova, Shqipëria dhe Kroacia kanë arritur në mars të këtij viti. “Ai [Vuçiq] mori rikonfirmimin tonë të përbashkët që kjo shënon një bashkëpunim që ka për qëllim mbrojtjen tonë dhe përgjigja ime ishte që në tërë historinë e ekzistencës sonë si komb ne asnjëherë nuk e kemi sulmuar askënd, s’e kemi pushtuar askënd, por gjithmonë e kemi mbrojtur dhe do të vazhdojmë ta mbrojmë integritetin tonë territorial. Aleanca tona janë aleanca mbrojtëse për të na mbrojtur nga



rreziqet që na vijnë nga të tjerët. Për Kosovën, rreziku na vjen nga Serbia kështu që ne do të vazhdojmë ta fuqizojmë ushtrinë tonë”, tha Osmani.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha për mediat se gjatë takimit në Durrës kishte pasur përplasje me Osmanin kur u diskutua për integritetin territorial, që sipas tij, çdokush e interpreton siç do. “Imagjini kur Vjosa Osmani vjen dhe flet për integritetin territorial dhe mbrojtjen e integritetit territorial. Të rrotullohet stomaku dhe të gjithë e dëgjojnë dhe tundin kokën... Prandaj, unë ja kujtova ditët e saj të turizmit në Kombet e Bashkuara, i urova që të ketë më shumë turizëm në jetën e saj dhe kjo ishte”, tha Vuçiq. Udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor u mblodhën të hënën në Durrës të Shqipërisë për Samitin rajonal Bërdo-Brioni, duke zhvilluar bisedime për të ardhmen e rajonit në Bashkimin Evropian (BE).

Duke folur në hapje të seancës plenare të këtij tubimi, presidenti i Shqipërisë si mikpritës i ngjarjes,

Bajram Begaj, tha se Tirana e mbështet dialogun rajonal, me fokus bashkëpunimin dhe procesin e integritetit evropian. “Për, ne bashkëpunimi rajonal mbetet instrumenti kryesor i integritetit të rajonit në BE. Duhet të vazhdojmë t’i shkëmbejnë përvojat dhe njohuritë tona për të pasur rezultate akoma më të prekshme nga ky proces i Bërdo-Brionit”, tha Begaj.

Tema e samitit të sivjetshëm ishte “Interesa të përbashkëta, angazhim i përbashkët për një të ardhme të përbashkët: Së bashku drejt BE-së”.

Takimi u përqendrua në të ardhmen evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal, posaçërisht në Planin e Rritjes së BE-së për rajonin.

Derisa Kosova ngel vendi i vetëm nga rajoni që ende nuk e ka statusin e vendit kandidat për në BE, Shqipëria ka shënuar përparim të madh kohëve të fundit duke i hapur shumicën e kapitujve të negociatave për anëtarësim, me vendet e tjera që kanë ngecur në këtë pikë.

Pas samitit, Osmani tha se procesi i anëtarësimit në BE nuk bazohet në merita, sepse, po të ishte kështu, tha ajo, Kosova “do të ecte shumë përpara dhe tani do të ishim shumë afër anëtarësimit. Por, fatkeqësisht zhvillimet politike në disa shtete anëtare po e bllokojnë këtë”.

Sa i përket Planit të Rritjes së BE-së, një paketë prej 6 miliardë eurosh e miratuar më 2023, të gjitha vendet e rajonit i kanë pranuar mjetet e para, ndërsa Kosova dhe Bosnja ende jo.

Kosovës po i kushton mungesa e një Kuvendi të ri, pas zgjedhjeve të shkurtit, pasi i duhet ta ratifikojë marrëveshjen e nevojshme fillimisht, ndërsa Bosnja s’e ka dorëzuar ende agjendën e kërkuar të reformave tek autoritetet evropiane.

Kosova është përfaqësuar nga presidentja Vjosa Osmani në këtë samit, ku morën pjesë edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ai i Malit të Zi Jakov Milatoviq, anëtarët e Presidencës së Bosnjës, si dhe presidentja e Maqedonisë së Veriut, Gordana Siljanovska-Davkova.

Samiti u zhvillua në një moment kyç për Ballkanin Perëndimor, ku përveç temës së integritetit evropian, u trajtuan edhe çështje që lidhen me forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ruajtjen e stabilitetit politik në rajon.

Ky samit gjithashtu i solli Osmanin dhe Vuçiqin përballë për herë të parë pas një shkëmbimi akuzash ndaj njëri-tjetrit kohëve të fundit në lidhje me sigurinë në rajon.

Osmani tha në fundjavë se “thirrjet e pamatura” të presidentit serb për luftë janë jehonë e rrezikshme e kapitujve më të errët të historisë së kohëve të fundit.

Reagimi i Osmanit erdhi pasi Vuçiq tha të premten se “të gjithë po përgatiten për luftë” dhe se Kosova po “përpiqet ta përdorë këtë kohë para luftës” për t’i bindur shumicën e shteteve evropiane dhe vendet e NATO-s t’ia mbajnë anën Prishtinës.

Edhe Vuçiq po i referohej komenteve të mëparshme të presidentes kosovare kur foli për luftën, pasi javën e kaluar në samitin e Komunitetit Politik Evropian në Danimarkë, Osmani i kishte bërë thirrje Evropës t’i parandalojë “taktikat agresive dhe destabilizuese” të Serbisë ndaj fqinjëve të saj.

Takimi është organizuar nga presidentja e Sllovenisë, Natasha Pirc Musar, dhe presidenti i Kroacisë, Zoran Milanoviq, dy prej nismëtarëve të samitit, nën udhëheqjen e presidentit shqiptar Begaj, si nikoqir i takimit në Durrës.

Kjo nismë rajonale, e nisur në vitin 2013 nga Sllovenia dhe Kroacia, synon të forcojë dialogun dhe bashkëpunimin mes vendeve të rajonit, si dhe të lehtësojë përpjekjet e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

KRYEMINISTRI I FRANCËS LECORNU JEP DORËHEQJE VETËM NJË MUAJ PASI U EMËRUA

PARIS, 6 TETOR - Kryeministri i ri i Francës, Sebastien Lecornu, ka dhënë dorëheqje të hënën, vetëm 14 orë pasi e kishte emëruar kabinetin e tij të ri, pasi aleatët dhe kundërshtarët e kërcënuan se do ta rrëzonin Qeverinë e tij. Dorëheqja e tij e shpejtë ishte e papritur dhe e pashembullt, duke e thelluar edhe më tej krizën politike në Francë.

Partia e ekstremit të djathtë, Tubimi Kombëtar, kërkoi menjëherë nga presidenti Emmanuel Macron të shpallë zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Pas konsultimeve disajavore me parti nga i gjithë spektri politik,

Lecornu, i cili është aleat i ngushtë i Macronit, kishte emëruar ministrat e tij të dielën, dhe ata pritej të mbanin mbledhjen e parë të kabinetit të hënën pasdite. Por, përbërja e re e kabinetit zemëroi si kundërshtarët, ashtu edhe aleatët, të cilët e konsideruan atë ose tepër të djathtë, ose pamjaftueshëm të tillë, duke ngritur pyetje se sa gjatë mund t’ia dalë ajo në një kohë kur Franca tashmë ndodhet në krizë të thellë politike, me një Parlament ku asnjë grup nuk ka shumicë.

Lecornu dorëzoi dorëheqjen e tij para Macronit të hënën në mëngjes. “Zoti Sebastien Lecornu ka paraqitur dorëheqjen e

Qeverisë së tij para presidentit të Republikës, i cili e ka pranuar atë”, tha zyra për shtyp e Elizesë. Politika franceze është bërë gjithnjë e më e paqëndrueshme që prej rizgjedhjes së Macronit në vitin 2022, për shkak të mungesës së një partie apo koalicioni me shumicë parlamentare.

Vendimi i Macronit për të thirrur zgjedhje të parakohshme parlamentare vitin e kaluar e thelloi edhe më shumë krizën, duke prodhuar një Parlament edhe më të ndarë. Lecornu, i cili u emërua muajin e kaluar, ishte kryeministri i pestë i Macronit brenda dy vjetësh. “Nuk mund të



ketë kthim në stabilitet pa kthim në kutitë e votimit dhe shpërbërjen e Asamblesë

Kombëtare”, tha lideri i Tubimit Kombëtar, Jordan Bardella, pas dorëheqjes së Lecornut.

FONDI I SIGURISË PËR USHTRINË NUK ËSHTË KLASIFIKUAR KURRË NGA MINISTRIA E FINANCEVE

PRISHTINË, 6 TETOR - Fondi i Sigurisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i themeluar në vitin 2022, asnjëherë nuk është klasifikuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), çka lë hapësirë për keqpërdorime dhe manipulim të dokumentacioneve.

Në bazë të ligjit në fuqi, një fond i tillë do të mund të konsiderohej i klasifikuar vetëm nëse përfshihej nën kornizën e Ligjit për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, gjë që do të justifikonte edhe mospublikimin e detajeve rreth donacioneve dhe shpenzimeve për FSK-në. Por, sipas burimeve të “Albanian Post”, një vendim i tillë nuk është marrë kurrë nga MFPT-ja.

Për më tepër, mungesa e klasifikimit e bën të pamundur aktivizimin e institucioneve mbikëqyrëse si Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), të cilat nuk mund të kryejnë kontrolle dhe inspektime mbi fondin pa statusin ligjor të informacionit të klasifikuar.

Kjo ngrit dilema të mëdha mbi transparencën institucionale pasi që në njërin anë, ministria nuk ka bërë të ditur asnjëherë se sa mjete janë grumbulluar dhe si janë menaxhuar ato përmes këtij fondi, duke e lënë opinionin publik në pasiguri. Në anën tjetër, mungesa e klasifikimit ligjor heq çdo arsytim zyrtar mbi mospublikimin e informacionit. Që nga fillimi i muajit shtator, “Albanian Post” ka kërkuar qasje në dokumentin zyrtar që e klasifikon Fondin e Sigurisë. Edhe pse kërkesa u aprovua nga zyrtarja e lartë, Luljeta Muqolli, nga kabineti i drejtorit të përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, qasja në këtë dokument nuk është mundësuar asnjëherë. “Ju konfirmoj pranimin e kërkesës suaj, të bazuar në Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasjen në Informata Publike. Do të kemi



konsideratë t’ju përgjigjemi brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi”, ishte përgjigja e Muqollit, më 10 shtator.

Pse fondi për FSK-në do të duhej të ishte i klasifikuar?

Njohësi i çështjeve të drejtësisë, Asdren Bytyqi, në një bisedë për “Albanian Post” sqaron se Fondi i Sigurisë do të duhej të ishte i klasifikuar, pasi që përfshin interesa shtetërore.

Kjo, sipas tij, vlen edhe për vendime të tjera që kanë interes specifik shtetëror, siç është rasti i këtij fondi. “Zakonisht, bëhet fjalë për informacione që lidhen me aktivitetet shkencore, teknologjike, ekonomike ose financiare, të cilat kanë lidhje me interesat e sigurisë dhe interesat strategjike shtetërore. Autoritetin për klasifikim e kanë kryesisht ministri dhe ministrat që veprojnë brenda sektorëve kritikë, si ministri i Financave dhe ministri i Mbrojtjes, por kompetencat mund të delegohen edhe te Agjencia për Mbrojtjen e

Informacionit të Klasifikuar”, ka thënë Bytyqi.

Ai ka shtuar se nivelet e klasifikimit ndryshojnë varësisht nga sekretësia dhe konfidencialiteti i informacionit. Çdo klasifikim, sipas tij, mbrohet në përputhje me procedurat e vendosura nga kryeministri dhe në koordinim me Agjencinë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, e cila është autoritet i sigurisë kombëtare në vend dhe institucion i specializuar për fushën e informacionit të klasifikuar. “Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar kanë të drejtë ligjore të kryejnë inspektime në të gjitha institucionet lidhur me keqpërdorimin e të dhënave, përfshirë edhe fondet e klasifikuara. Ky nen synon pikërisht të parandalojë abuzimet me sekretet e informacionit”, ka sqaruar Bytyqi për AP.

Në praktikën ndërkombëtare, fondet e sigurisë shpesh klasifikohen pjesërisht, me qëllim mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme strategjike, por

gjithmonë duke ruajtur një nivel të caktuar transparence për opinionin dhe institucionet mbikëqyrëse.

Në rastin e Kosovës, megjithatë, asnjëra prej këtyre dy qasjeve nuk është ndjekur.

Në anën tjetër, për mospublikimin e donacioneve, institucionet vazhdimisht janë mbrojtur pas një vendimi të ish-drejtorit të Thesarit, Ahmet Ismajli (tash guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës), i cili deklaronte se “informacionet për Fondin e Sigurisë janë konfidenciale/të fshehta”.

Në vendimin e tij thuhej se këto donacione janë të dedikuara vetëm për Ministrinë e Mbrojtjes, dhe çdo hapje e paautorizuar e të dhënave, veçanërisht e shumës së mbledhur dhe e numrit të kontribuuesve, mund të dëmtonte interesat e sigurisë së Kosovës, në rrafshin rajonal dhe më gjerë.

Ish-koloneli i FSK-së, Afrim Veseli, thotë për Albanian Post se është jashtëzakonisht shqetësuese që nuk është ndarë asnjë informacion mbi mjetet e grumbulluara deri tani për Fondin e Sigurisë. “Së pari, jo-transparenca krijon mundësinë

për keqpërdorim të fondeve, dhe kjo dëmton besimin e atyre që kanë kontribuar financiarisht për forcimin e mbrojtjes së Kosovës. Së dyti, çdo mjete që janë mbledhur duhej të destinoheshin menjëherë për FSK-në dhe të shiheshin rezultatet konkrete”, sqaron Veseli.

Ai pohon se në një shtet ligjor formimi i fondeve të tilla duhet të jetë plotësisht transparent, dhe secili që ka kontribuar duhet të mund të shohë emrin e tij. “Me transparencë të plotë, qytetarët e tjerë gjithashtu do të inkurajoheshin të mbështesnin fondin. Nuk e di saktësisht, por ndoshta fondi ka dështuar, dhe publikimi i të dhënave mbi shumën e mbledhur është i vogël, ndoshta për të shmangur dëme politike për ata që e kanë formuar”.

Lidhur me këtë çështje, edhe disa organizata joqeveritare kishin shprehur shqetësimin për mënyrën se si administrohen paratë në Fondin e Sigurisë. Sipas tyre, për të siguruar transparencë, fondi duhej të rregullohej me ligj. Kur ish-ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, kishte bërë thirrje për të kontribuar në Fondin e Sigurisë, dhjetëra qytetarë kishin komentuar në postimin e tij në rrjetin social “Facebook”, disa prej të cilëve kishin shpërndarë edhe shumat e depozituara në llogarinë e fondit. Shumat e dhuruara varionin nga 10 deri në mbi 1 mijë euro.

Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK), që nga viti 2018, është në proces të shndërrimit në ushtri. Parashikohet që deri në vitin 2028, ajo të arrijë të gjitha kapacitetet operationale për, siç thuhet, “ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe mbrojtjen e qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit”.

Aktualisht, FSK-ja ka rreth 2 mijë e 500 pjesëtarë. Pas përfundimit të periudhës së tranzicionit, pritet që ky numër të rritet në mbi 7 mijë e 500, duke përfshirë pjesëtarë aktivë dhe rezervistë.

KQZ-ja refuzon certifikimin e shtatë OJQ-ve, kërkon transparencë financiare

PRISHTINË, 6 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në mbledhjen e mbajtur të hënën, ka miratuar rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar për të moscertifikuar shtatë organizata joqeveritare dhe vëzhguesit e tyre për zgjedhjet e 12 tetorit.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Sami Kurteshi, ngriti çështjen e burimeve të financimit të

vëzhguesve.

Ai theksoi se është e domosdoshme të dihet nëse vëzhguesit janë vullnetarë apo të paguar, dhe nëse paguhen, nga vijnë mjetet financiare. “Nëse vëzhguesit paguhen, duhet të dihet qartë prejardhja e mjeteve. Transparenca për fondet është e domosdoshme, pasi çdo shfrytëzim i mjeteve publike lidhet drejtpërdrejt me interesin publik”, tha Kurteshi. Ai shtoi se edhe pagesat simbolike për një numër të

madh vëzhguesish, siç është rasti me 259 persona, përbëjnë një shumë të konsiderueshme, e cila duhet të jetë e justifikuar dhe e dokumentuar.

Në të njëjtën mbledhje, KQZ miratoi gjithashtu procedurat për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në kuadër të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Dokumenti i miratuar përshkruan në mënyrë të detajuar të gjitha proceset dhe aktivitetet që do të zhvillohen në QNR.





Bujar Tereshina (RFE/RL)

“LIRI, SHPRESË APO ZHGËNJIM”: VERIU I KOSOVËS DREJT RIKTHIMIT NËN UDHËHEQJEN E SERBËVE

Banorët serbë të komunave veriore të Kosovës janë të ndarë mes shpresës dhe skepticizmit për zgjedhjet e 12 tetorit: disa e presin rikthimin e serbëve në krye të komunave si “liri”, ndërsa të tjerët nuk presin ndryshime të mëdha

MITROVICË, 6 TETOR - Banorët serbë të komunave veriore të Kosovës janë të ndarë mes shpresës dhe skepticizmit për zgjedhjet e 12 tetorit: disa e presin rikthimin e serbëve në krye të komunave si “liri”, ndërsa të tjerët nuk presin ndryshime të mëdha. Pas dorëheqjes së zyrtarëve të Listës Serbe në nëntor të vitit 2022, komunat veriore u morën nga kryetarët shqiptarë. Lista Serbe synon rikthimin në pushtet dhe anulimin e vendimeve të kryetarëve shqiptarë, por autoritetet lokale thonë se vendimet e miratuara në përputhje me ligjin, nuk mund të zhbëhen. Ndërsa zgjedhjet lokale të 12 tetorit afrohen, banorët e Mitrovicës së Veriut, të anketuar nga “Radio Evropa e Lirë”, janë të ndarë mes shpresës dhe skepticizmit. Disa mezi presin të shohin largimin e kryetarëve shqiptarë nga pushteti; të tjerët nuk presin ndryshime të mëdha: institucionet e mbyllura të Serbisë, thonë ata, nuk do të kthehen më. Katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku - udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë, pasi në nëntor

të vitit 2022, të gjithë përfaqësuesit e Listës Serbe dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës, si reagim ndaj vendimit të autoriteteve kosovare për t'i hequr targarat serbe të makinave. Instalimi i kryetarëve shqiptarë u pasua me protesta të dhunshme nga qytetarët serbë, të cilat rezultuan me dhjetëra njerëz të plagosur - në mesin e tyre edhe ushtarë të misionit të NATO-s, KFOR. Në prill të vitit 2023, serbët, duke ndjekur udhëzimet e Listës Serbe, nuk morën pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme në këto komuna. Ata bojkotuan edhe votimin për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në prill të vitit 2024. Gjatë gjithë kësaj kohe, tensionet vazhduan, për shkak të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për të vendosur kontrollin atje. Situata kulmoi me një sulm të armatosur të një grupi serbësh në fshatin Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit 2023. Përgjegjësinë për kryerjen e tij e mori ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq. Kosova, në anën tjetër, arriti disa qëllime: hoqi targarat serbe, ndaloi përdorimin e dinarit serb dhe mbylli shumicën e institucioneve

serbe që funksiononin në veri - në mesin e tyre: posta, banka, autoritete të përkohshme komunale, qendra për punë sociale, ndërmarrje publike e të tjera. Në vend të atyre serbe, u hapën institucionet, zyrat postare dhe bankat e Kosovës. Autoritetet lokale morën përsipër ndërtesat ku kishin vepruar institucionet serbe, ndaluan ndërtimet “e paligjshme” të financuara nga Serbia ose paralajmëruan prishjen e vendbanimeve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, u hapën biznese në pronësi të shqiptarëve, si supermarkete, restorante me ushqime të shpejta dhe pasticeri, por që u përballën me bojkotim nga komuniteti lokal serb. Sot, Lista Serbe “numëron mbrapsht” deri në zgjedhjet lokale të 12 tetorit, për të zëvendësuar kryetarët shqiptarë, të cilët i konsideron si “të paligjshëm”. Gjatë fushatës, partia më e madhe e serbëve në Kosovë - e cila vazhdimisht i fitoi zgjedhjet prej se u formua në vitin 2013 - pranoi se ishte gabim të largohej nga institucionet e Kosovës, duke thënë se qëllimi ishte t’ia tërhiqte vëmendjen komunitetit ndërkombëtar për “pozitën e vështirë të serbëve”. “Sot duhet t’i korrigjojmë ato gabime. Kishim shpresa te komuniteti ndërkombëtar, por nuk morëm asgjë. Mjerim. Asgjë nuk na kuptuan...”, tha Sërgjan Vulloviq, nga Lista Serbe, në një tubim parazgjedhor në Zubin Potok.

Çka presin qytetarët?

Radovani nga Mitrovica e Veriut pret që pas 12 tetorit komuna e tij të udhëhiqet nga serbët dhe se “do të ketë sërish liri”. “Liria është gjëja më e çmuar dhe pjesa tjetër varet nga populli”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”. Radovani e konsideron si “mungesë lirie” faktin që komunat në veri të Kosovës udhëhiqen nga kryetarët shqiptarë, për të cilët thotë se kanë marrë vendime që i kanë dëmtuar serbët. Ai e kundërshton edhe hapjen e bizneseve shqiptare në Mitrovicë të Veriut. “Ata mendojnë se janë kryesorët, por nuk janë. E shihni, kanë pushtuar gjysmën e [shëtitores]”, thotë Radovani, duke shtuar se nuk ka asgjë kundër shqiptarëve, por se në veri jeton shumica serbe dhe se ajo duhet t’i marrë vendimet. Miroslavi ndan mendim të ngjashëm. Ai nuk shpreson për ndryshime të mëdha, por thotë se është e rëndësishme për të që “këta [kryetarët shqiptarë] të largohen”. Sllavica, në anën tjetër, nuk pret ndonjë ndryshim pas zgjedhjeve të 12 tetorit, sepse, siç thotë ajo, askush nuk mund t’i kthejë institucionet e mbyllura që funksiononin brenda sistemit serb. “Nëse na marrin shëndetësinë dhe arsimin, ne nuk kemi çfarë të kërkojmë këtu”, thotë ajo, dhe shton se dy djemtë e saj tashmë janë larguar, për shkak të situatës së paqëndrueshme në veri të Kosovës. “Një popull i zhgënjyer. Kjo nuk është mënyra e duhur”, thotë Sllavica.

Mira thotë se jeta në këtë zonë ka qenë shumë e vështirë në tre vjetët e fundit dhe nuk pret ndonjë përmirësim pas zgjedhjeve lokale. Arsyeja, sipas saj, është se shumica e institucioneve serbe janë mbyllur dhe se dinari është hequr, ndaj për të marrë të ardhurat e saj, duhet të shkojë në Serbi. Pjesëtarët e komunitetit serb marrin të ardhura të ndryshme nga buxheti i Serbisë, si: paga, pensione, shtesa për fëmijë dhe ndihma të tjera financiare. “Kam mbesën që ma merr pensionin në Serbi; përndryshe, nuk do të mund të shkoja, sepse nuk jam mirë me shëndet”, thotë Mira.

Pjesëmarrje e madhe?

Zoran Saviq, nga organizata joqeveritare në veri, Aktiv, i cili monitoron fushatën e zgjedhjeve lokale, thotë për Radion Evropa e Lirë se në mesin e popullsisë lokale në veri të Kosovës nuk ka optimizëm, por beson se pjesëmarrja në zgjedhje do të jetë e lartë. Ai thotë se, pavarësisht faktit se disa subjekte politike serbe marrin pjesë në garën zgjedhore, Lista Serbe do të fitojë, sepse është e vetmja parti që ka mbështetjen e Beogradit. “E dimë se si funksionon. Do të ketë votim kolektiv... të gjithë ata që janë në buxhetin e Republikës së Serbisë, do të votojnë. Kështu ishte rasti me çdo proces zgjedhor, në të cilin mori pjesë Lista Serbe”, thotë Saviq. Serbia i zhvendosi institucionet e

AFËR 3 MIJË RASTE ME KANCER TË GJIRIT NË KOSOVË GJATË KATËR VITEVE TË FUNDIT

PRISHTINË, 6 TETOR - Numri i rasteve të reja me kancer të gjirit në Kosovë ka shënuar rritje të vazhdueshme gjatë katër viteve të fundit, sipas të dhënave të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dërguar "Albanian Post". Vetëm gjatë vitit 2024 janë raportuar 633 raste të reja të kancerit të gjirit në Regjistrin Popullativ të Sëmundjeve Malinje të Departamentit të

Statistikave Shëndetësore. Kjo shifër përbën 17.4 për qind të të gjitha rasteve të sëmundjeve malinje të evidentuara gjatë atij viti. Sipas IKShPK-së, "numri total i rasteve të raportuara ka arritur në 1 mijë e 88, që përfaqëson 23.5 për qind të të gjitha sëmundjeve malinje". Më pak raste se në vitin 2024, ka pasur gjatë vitit 2023 dhe 2022 në Kosovë. "Në vitin 2023, janë regjistruar 617 raste të reja ose

14.8 për qind e totalit, ndërsa rastet e përgjithshme kanë qenë 1 mijë e 93 (21.9%). Ndërkohë, në vitin 2022, numri i rasteve të reja kishte qenë 543, që përbënin 17.5 për qind, me gjithsej 1 mijë e 119 raste të raportuara - pra 25.6 për qind të sëmundjeve malinje atë vit". Po ashtu, edhe në vitin 2021 dhe 2020 numri i rasteve ka qenë shumë i ulët. "Në vitin 2021 janë evidentuar 568 raste të reja (17.4%) dhe gjithsej 955 raste

(23.6%), ndërsa në vitin 2020 468 raste të reja (16.8%) dhe 780 raste në total (22.2%). Këto të dhëna tregojnë një rritje të vazhdueshme të rasteve të reja, nga 468 raste në vitin 2020 në 633 raste në vitin 2024". Sipas ekspertëve shëndetësorë, kjo tendencë rritëse mund të lidhet si me përmirësimin e raportimit dhe diagnostikimit, ashtu edhe me faktorët e riskut që mbeten të pranishëm tek gratë në Kosovë, si mungesa e

kontrollit të rregullt, stili i jetesës dhe trashëgimia gjenetike. Tetori, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, sjell çdo vit mesazhin global se kjo sëmundje mbetet një nga sfidat më të mëdha shëndetësore për gratë në mbarë botën. Me ngjyrën simbolike rozë, fushatat ndërkombëtare synojnë të rrisin ndërgjegjësimin, të edukojnë mbi faktorët e rrezikut dhe të nxisin mbështetjen për pacientët dhe familjet e tyre.



saj të mbyllura në Kosovë në territorin e saj dhe punonjësit vazhduan të marrin paga. Beogradi zyrtar u bëri thirrje serbëve në Kosovë, por edhe personave të zhvendosur në Serbi, që të votojnë për Listën Serbe. Komisariati për Refugjatë i Republikës së Serbisë kërkoi që të gjithë ata që kanë dokumente të Kosovës t'i drejtohen për organizimin e pjesëmarrjes në zgjedhje, ashtu siç ndodhi edhe për zgjedhjet parlamentare të shkurtit. Saviq thotë se pas zgjedhjeve, kryetarët e rinj do të përballen me një "realitet të ri", sepse autoritetet aktuale kanë ndryshuar pamjen e komunave: kanë fshirë muralet që lidheshin me Serbinë, kanë ndërruar emrat e vendbanimeve dhe rrugëve dhe gjëra të ngjashme. Një nga mesazhet kryesore të Listës Serbe është se do t'i anulohet të gjitha vendimet e "autoriteteve të paligjshme". Të njëjtën gjë e thonë edhe subjektet e tjera politike serbe, duke paralajmëruar rishikim të vendimeve ose marrëveshjeve të mëparshme.

A është e mundur të anulohen ose ndryshohen vendimet?

Kryetari aktual i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, thotë për

Radion Evropa e Lirë se vendimet që janë marrë tashmë në komunat e veriut të Kosovës, nuk mund të anulohen, sepse janë marrë në përputhje me rregulloret dhe ligjet e Kosovës. "Çdo vendim që merret, duhet të jetë në përputhje me ligjin. Janë nxjerrë rregullore që më parë nuk kanë ekzistuar. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i mundur, sepse nuk mund të kthehesh në anarki", thotë ai. Uglanin, i cili vjen nga komuniteti boshnjak, merr pjesë në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut që nga themelimi i tij në vitin 2013. Ai thotë se komuna filloi të punojë me kapacitet të plotë vetëm pas tërheqjes së Listës Serbe. "Rregulloret që ekzistojnë në të gjitha komunat e tjera, nuk ekzistojnë në komunat në veri: as për taksat, tarifat, gjokat... Ato nuk funksiononin siç duhej", thotë Uglanin. Ai shton se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka toleruar një "formë anarkie" në komunat veriore, sepse udhëhiqej nga Lista Serbe deri para disa vitesh. Sipas tij, vendimet e autoriteteve lokale në dy vjetët e fundit kanë kaluar procedurën parlamentare dhe i janë dërguar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim. "Ministria i shqyrton këto vendime, por deri më tani asnjë vendim nuk është anuluar", thotë Uglanin.

Kjo ministri, aktualisht, drejtohet nga ministri në detyrë, Elbert Krasniqi.

"Kthimi i Listës Serbe në institucione është i mundur, por jo i punonjësve që i braktisën"

Uglanin thotë se është shumë e mundur që Lista Serbe, pas zgjedhjeve lokale, të rikthehet në pushtet në komunat e veriut, por kjo nuk do të thotë se do të rikthehet edhe stafi administrativ që la detyrat e tij në vitin 2022, sepse, ndërkohë, janë punësuar njerëz të rinj. "Fatkeqësisht, punonjësit komunalë që [Lista Serbe] i detyroi të largoheshin nga institucionet, nga puna, nuk do të mund të kthehen. Do të kenë disa drejtorë komunalë dhe kaq", thotë ai. Saviq, nga organizata joqeveritare Aktiv, thotë gjithashtu se kthimi i të gjithë punonjësve që u larguan nga institucionet me ftesë të Listës Serbe, nuk do të jetë i mundur. "Vetëm ata [Lista Serbe] do të kthehen. Njerëzit që u detyruan në njëfarë mënyre nga Lista Serbe të largoheshin nga institucionet, nuk do të kthehen", sipas tij. Përveç politikanëve, nga institucionet e Kosovës në vitin 2022 u larguan edhe punonjësit e

administratës lokale, Policisë së Kosovës dhe gjyqësorit. Në zgjedhjet e ardhshme lokale më 12 tetor, Lista Serbe ka kandidatë për kryetarë komunash në të dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë: Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq, Zubin Potok, Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë, Klokot, Partesh dhe Ranillug, si dhe në Obiliq. Kandidatë në komunat me shumicë serbe kanë edhe disa parti tjera serbe: Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit, Demokracia Serbe e Aleksandar Arsenijeviqit, Lëvizja Popullore Serbe e Millija Bishevacit, Aleanca e Kosovës e Goran Marinkoviqit, si dhe disa iniciativa qytetare.

Çka thotë ligji?

Ligji për vetëqeverisjen lokale në Kosovë përcakton statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, bashkëpunimin brenda komunës dhe marrëveshjet ndërkomunale, përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet midis komunave dhe autoritetit qendror. Megjithatë, nuk sqaron në

mënyrë të qartë nëse një vendim i vetëqeverisjes lokale mund të anulohet nga pushteti që vjen më pas. Në pjesën e ligjit që lidhet me "mbikëqyrjen e legjislacionit" thuhet se nëse organi mbikëqyrës - në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ose institucionet e tjera përgjegjëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës - vlerëson se një vendim ose akt tjetër i komunës nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ai mund të kërkojë që komuna ta rishikojë atë vendim ose akt. "Kërkesa do të përmbajë arsyet e shkeljes së pretenduar të Kushtetutës ose ligjit dhe nuk do të pezullojë ekzekutimin e vendimit të komunës ose të ndonjë akti tjetër në fjalë", thuhet në ligj. Nëse organi komunal nuk përgjigjet ndaj kërkesës për rishqyrtim, organi mbikëqyrës mund ta kontestojë aktin përkatës para Gjykatës së Qarkut, kompetente për territorin e komunës, brenda 30 ditëve nga mosmarrja e përgjigjes, njoftimit për refuzim ose mbështetje të vendimit ose aktit në fjalë. Gjykata më pas mund të urdhërojë, përmes një mase të përkohshme, anulimin e vendimit ose aktit të kontestuar ose të akteve të tjera të përkohshme, në përputhje me ligjin.

Policia me fushatë vetëdijësuese "Duart në timon, jo në telefon"

FERIZAJ, 6 TETOR - Drejtorja Rajonale e Policisë në Ferizaj ka nisur projektin fushatë vetëdijësuese "Duart në timon, jo në telefon", e cila do të zbatohet nga Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor, në bashkëpunim me stacionet policore vartëse të Drejtorisë Rajonale në Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Han të Elezit, si dhe me mbështetjen e OJQ-së "Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt".

Kjo fushatë është konceptuar dhe hartuar nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e DRP-Ferizaj, me qëllim që të përcillet një mesazh i qartë dhe sensibilizues për të gjithë pjesëmarrësit në trafik: "Një sekondë në telefon mund të jetë shumë vonë. Duart në timon, e jo në telefon". Në kuadër të fushatës, do të zhvillohen aktivitete të ndryshme, si: shpërndarja e fletëpalosjeve informuese;

vendosja e posterëve në rrugë dhe sheshe publike; mbajtja e ligjëratave vetëdijësuese në shkollat e rajonit të Ferizajt. Faza e parë e projektit do të ketë karakter parandalues dhe edukativ dhe do të zgjasë deri më 12 tetor 2025. Ndërsa, nga data 13 tetor 2025, policia do të fillojë zbatimin e masave ndëshkuese ndaj të gjithë atyre që nuk respektojnë ligjin e trafikut dhe rrezikojnë sigurinë rrugore.



BELGJIKA SYNON MARRËVESHJE ME KOSOVËN DHE SHQIPËRINË PËR BURGJE

PRISHTINË, 6 TETOR - Ministria e Drejtësisë e Belgjikës, Annelies Verlinden, dhe ajo e Azilit dhe Migrit, Anneleen Van Bossuyt, kanë nisur një vizitë treditore në Shqipëri dhe në Kosovë, që do të përqendrohet në mundësinë e marrjes me qira ose ndërtimin e një burgu në njërin prej këtyre shteteve.

Një marrëveshje për dhënien me qira të qelive Kosova ka me Danimarkën.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar Ministrisë në detyrë të Drejtësisë për mundësinë e një marrëveshjeje për burgjet edhe me Belgjikën dhe është ende në pritje të përgjigjes.

Kjo vizitë e dy ministereve belge do të përqendrohet në fuqizimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, rimarrjen e aseteve kriminale jashtë vendit dhe trajtimin e mbipopullit në burgjet belge dhe migrit.

Ministret, sipas DeMorgen, që janë nisur sot drejt Shqipërisë, do



të insistojnë që Tirana zyrtare të pranojë rikthimin e shtetasve të saj që mbahen në burgjet belge. Këtu përfshihen 307 shtetas shqiptarë, prej të cilëve 253 nuk kanë leje qëndrimi. "Ata që janë

të dënuar këtu dhe nuk kanë leje qëndrimi mund ta vuajnë dënimin në vendin e tyre të origjinës, atëherë kjo do të nënkuptojë një ekzekutim të drejtë të dënimit, ashtu edhe

rritje të konsiderueshme të efikasitetit për institucionet tona të burgjeve", tha Verlinden.

Gjatë kësaj vizite, sipas Verlinden, do të diskutohet për një memorandum mirëkuptimi për asetet, në mënyrë që pasuritë e konfiskuara në rastet penale në Kosovë dhe Shqipëri, mbi bazën e informacionit nga hetimet në Belgjikë, pjesërisht të mund të kalojnë në arkën e shtetit belg.

Ministria Verlinden tha se ka bashkëpunim pozitiv me Kosovën dhe Shqipërinë.

Sipas Belgjikës, Kosova është vend transit për trafikim me qenie njerëzore dhe kontrabandë të armëve dhe shpesh shfaqet në rastet gjyqësore belge si vend për pastrim të parave.

Ndërkaq, Shqipëria thuhet se është partnere strategjike në luftën kundër trafikimit të drogës dhe ka një prani të fuqishme të organizatave kriminale shqiptare në portin e Antverpit. "Ballkani Perëndimor aktualisht është rajoni kyç në luftën tonë kundër

krimit të organizuar. Dua të mbështetemi në besim të ndërsjellë i cili është ndërtuar përmes bashkëpunimit intensiv në vitet e fundit", tha ministria Verlinden.

Në Kosovë do të zhvillohen bisedime për nënshkrimin e një traktati për ndihmë juridike, i cili, sipas Belgjikës do të synojë të forcojë në mënyrë strukturore bashkëpunimin për çështjet penale.

Kosova veçse ka një marrëveshje për dhënien me qira të qelive me Danimarkën. Të burgosurit e parë nga ky shtet do të vendosen në burgun e qytetit të Gjilanit në prill të vitit 2027.

Marrëveshja dhjetëvjeçare parasheh shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan për dërgimin e 300 të burgosurve nga shteti danez.

Në këmbim, Kosova do të përfitojë mbi 200 milionë euro. Kuvendi i Kosovës e ratifikoi marrëveshjen më 23 maj 2024, dy vjet pasi ajo ishte nënshkruar.

URAN ISMAILI ME KONTRATË PËR QYTETARËT E PRISHTINËS, FTON TË GJITHË TA NËNSHKRUAJNË DHE TA MBAJNË PËRGJEGJËS PËR ZOTIMET E TIJ



PRISHTINË, 6 TETOR - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, bashkë me ekipin e tij ka shpërndarë sot numrin e shtatë të gazetës javore "Koha për Prishtinën", e cila këtë javë vjen me titullin "Koha për Uranin". Në këtë numër trajtohen 5 zgjidhjet emergjente të Ismailit për ta kthyer Prishtinën në një qytet funksional.

Faqja e parë e gazetës përmban zotimin e tij në formë kontrate me qytetarët, të nënshkruar nga

vetë ai, ku zotohet se nëse nuk përmbush 90% të premtimeve gjatë mandatit të parë, nuk do të kërkojë votë për një mandat të dytë.

Ai ka ftuar qytetarët që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe ta mbajnë përgjegjës për realizimin e zotimeve të tij. Në faqen e dytë paraqiten 10 vendimet e para që Ismaili do të marrë menjëherë pas zgjedhjeve, ndërsa faqja e tretë përmban 5 zgjidhjet për Prishtinën

funksionale: Hapja e sheshit "Xhorxh Bush", zhbllokimi i trafikut brenda 18 muajsh, lagje të pastra 24/7, rrugë të sigurta 24/7, dhe pezullimi i lejeve të reja ndërtimore për 6 muajt e parë, si pjesë e planit "Nga betoni te komuniteti".

Në faqen e fundit gjenden udhëzimet për mënyrën e votimit më 12 tetor, si dhe një karikaturë që pasqyron përjetimet e përditshme të qytetarëve të Prishtinës.

Fillon bashkëpunimi i Prishtinës me operatorët privatë të transportit të ri të Prishtinës (TRIP)

PRISHTINË, 6 TETOR - Të hënën ka filluar zyrtarisht bashkëpunimi i Prishtinës me operatorët privatë të transportit të ri të Prishtinës (TRIP) për zbatimin e

projektit të tram-it elektrik në vitin 2026.

Kryetari aktual i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se ky është një tjetër hap drejt planit

dhe vizionit për mobilitetin në kryeqytet. "Vizioni ynë po realizohet. Po e modernizojmë flotën e autobusëve sipas standardeve më të larta

ndërkombëtare, po e ulim ngarkesën e trafikut në Prishtinë dhe po e vendosim qytetarin në qendër", ka shkruar Rama në "Facebook".



EKSPERTI MJEKOLIGJOR I THOTË GJYKATËS SË LIRIDONA ADEMAJ U VRA NGA NJË LARGËSI PREJ 2 DERI NË 5 CENTIMETRA

PRISHTINË, 6 TETOR - Një ekspert mjekoligjor ka thënë në gjykatë se Liridona Ademaj ishte vrarë nga një largësi prej 2 deri në 5 centimetra në vitin 2023, teksa dha dëshminë e tij të hënën në një seancë në gjyqin kundër Naim Murselit, Kushtrim Kokallës dhe Granit Plavës. Naim Uka - i cili ka kryer autopsinë e tani të ndjerës Liridona Ademaj - tha në Gjykatën Themelore në Prishtinë se “gjatë ekzaminimit të plagës hyrëse kemi konstatuar përreth vrimës hyrëse prezencën e faktorëve plotësues të qitjes, të cilët kanë shkaktuar edhe djegien lëkurore me prezencë të grimcave të barutit”. “Në bazë të këtyre provave mjekoligjore është konstatuar se distanca e qitjes sillet prej 2 deri në 5 centimetra”, tha Uka, sipas “Betimit për Drejtësi”.

Liridona Ademaj u vra në moshën 30-vjeçare më 29 nëntor 2023 në një rrugë në fshatin Bërnice të Prishtinës. Për vrasjen e saj po gjykohen bashkëshorti i saj Naim Murseli, si dhe Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla. Murseli dhe Kokalla janë deklaruar të pafajshëm, ndërsa Plava nuk ka pranuar të deklarohet për fajësinë. Eksperti mjekoligjor Uka i tha tutje gjykatës së është plaga kishte formë trekëndëshe, e cila ishte shoqëruar me thyerje të shumëfishta. “Edhe në këtë rast, kemi kryer ekzaminimin e dy duarve të së ndjerës, në mënyrë që, bazuar në prezencën apo mungesën e faktorëve plotësues të qitjes dhe njollave të gjakut, është eliminuar mundësia që e njëjta të ketë përdorur ndonjë armë apo të ketë shkaktuar vetëvrasje”, tha ai.

Gjykimi në këtë rast nisi në fillim të këtij viti, ndërsa në seancën e kaluar dëshmoi vëllai i Liridonës, Leonard Ademaj, i cili tha se sjellja e Muselit menjëherë pas vrasjes e kishte tronditur familjen e tyre.

Si ishte kryer vrasja?

Aktakuza e ngarkon Murselin se e ka planifikuar vrasjen e bashkëshortes me qëllim hakmarrjeje dhe përfitimi financiar nga një sigurim jetësor në Suedi, në shumë prej rreth 260 mijë eurosh.

Sipas Prokurorisë, Murseli e ka planifikuar vrasjen në bashkëpunim me Kushtrim Kokallën dhe Granit Plavën, duke u premtuar atyre një shpërblym prej 30 mijë eurosh për ta kryer krimin.

Kokalla akuzohet se e kishte njoftuar Murselin me dorasin



Plava.

Plava akuzohet se ka kryer vrasjen.

Vrasja e Liridona Ademajt shkaktoi zemërim publik, veçanërisht pasi bashkëshorti i saj mori pjesë në varrim.

Familja kërkoi zhvarrosjen e trupit të saj për ta varrosur në

varrezat e familjes Ademaj.

Që nga viti 2010, në Kosovë u vranë rreth 60 gra - shumica nga bashkëshortët e tyre. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kritikojnë sistemin e drejtësisë për dënime të lehta të autorëve - gjë që, sipas tyre, i trimëron dorasit.

INSPEKTORATI I ARSIMIT BËHET EDHE ME 22 INSPEKTORË TË RINJ

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 TETOR - Në prani të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ministres në detyrë të Arsimit, Arbërie Nagavci dhe Sekretares së Përgjithshme, Fadile Dyla, Inspektorati i Arsimit hapi Punëtorinë me temën “Praktikat e mira për inspektim efektiv”, për të theksuar rolin e inspektorit si partner udhëzues në rrugën drejt përmirësimit të cilësisë në arsim. Në fjalën e tij përshëndetëse, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, vlerësoi punën dhe përkushtimin e inspektorëve të arsimit në mbikëqyrjen dhe garantimin e cilësisë së arsimit në Kosovë, duke theksuar se Inspektorati i Arsimit është shtylla kryesore e zbatimit të politikave arsimore dhe garantuesi i respektimit të standardeve në institucionet arsimore publike dhe private. “Roli i Inspektoratit nuk është të ndëshkojë, por të udhëzojë, këshillojë dhe përkrahë institucionet arsimore. Ju jeni partnerë të mësimdhënësve dhe



drejtuesve të shkollave, bashkudhëtarë në rrugëtimin për cilësi. Për këtë arsye, MASHTI do të vazhdojë të investojë në trajnime, kushte më të mira pune dhe ngritje profesionale të vazhdueshme”, theksoi kryeministri Kurti.

Kurti kujtoi se për shumë vite Inspektorati i Arsimit ka funksionuar me vetëm 25 inspektorë për tërë vendin, por falë përkushtimit të Qeverisë së Kosovës dhe MASHTI-t, ky numër tashmë është rritur, duke përfshirë 22 inspektorë të rinj që janë pranuar kohët e fundit.

Në anën tjetër, ministrja Nagavci vlerësoi punën e Inspektoratit për realizimin për herë të parë të procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për nivelin e licencës së avancuar, si një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit profesional dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie.

Ministrja Nagavci përmendi edhe një sërë investimesh e arritjesh që kanë ndikuar në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit arsimor, përfshirë: miratimin e 9 ligjeve dhe projektligjeve dhe 41 udhëzimeve administrative që rregullojnë proceset në të gjitha nivelet e

arsimit; hartimin e Strategjisë së Arsimit 2022-2026; miratimin e Projektligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) dhe ndërtimin e 14 çerdheve të reja, me mbështetje edhe nga Bashkimi Evropian, 29 të tjera të cilat janë në proces të ndërtimit dhe 5 në proces të tenderimit; ndërtimin e 18 shkollave të reja, renovimin e 8 shkollave ekzistuese, si dhe ndërtimin e 15 sallave sportive në mbarë vendin; forcimin e arsimit profesional dhe dual, përmes përfshirjes së mbi 900 nxënësve në 23 shkolla, trajnimit të instruktorëve dhe pjesëmarrjes së

Kosovës në Aleancën Evropiane për Praktikat Profesionale. Ministrja theksoi se të gjitha këto investime e reforma nuk janë të ndara nga puna e Inspektoratit të Arsimit, por shkojnë drejt përmirësimit të kushteve të mësimdhënies dhe lehtësimit të punës së inspektorëve në terren, duke forcuar sistemin arsimor në tërësi.

Në fund të fjalës së saj, ministrja Nagavci u shprehu falënderim të gjithë inspektorëve për angazhimin, profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre të përditshëm.

Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit, Besa Bytyqi Baraliu, tha se, mbështetja e ministres Nagavci dhe Qeverisë së Kosovës ndaj Inspektoratit të Arsimit është një dëshmi e qartë se cilësia në arsim është prioritet kombëtar.

“Kjo na motivon të punojmë me përkushtim edhe më të madh për të garantuar një sistem arsimor ku çdo institucion funksionon me standarde të larta profesionalizmi dhe përgjegjësie”, shtoi ajo.

Arianit Koci, anëtar i Bordit të AKB-së: Korrupsioni s’është më skandal, është stil jete në Kosovë

PRISHTINË, 6 TETOR - Anëtari i Bordit Drejtues të Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Arianit Koci, ka ngritur alarmin se korrupsioni dhe krimi i organizuar janë bërë pjesë e përditshmërisë në Kosovë, duke shndërruar një dukuri të rrezikshme në “mënyrë jetese”. Në mbledhjen e fundit të Bordit të AKB-së, Koci tha se ky fenomen ka depërtuar në çdo nivel të shoqërisë dhe po e dëmton rëndë zhvillimin ekonomik e moral të vendit. “Në

Kosovë, korrupsioni dhe krimi i organizuar nuk janë më përjashtime - janë bërë praktikë e zakonshme në shumë segmente të jetës publike e institucionale. Ky realitet po godet bizneset e ndershme, po dekurajon investitorët dhe po e shkatërron besimin e qytetarëve te shteti”, ka theksuar Koci.

Sipas tij, Kosova ka nevojë urgjente për veprime konkrete, jo vetëm për deklarata politike: “Pa drejtësi të pavarur, pa ndëshkim për abuzuesit dhe pa sundim të

ligjit, nuk ka ekonomi të shëndoshë. Sektori privat po paguan çmimin më të lartë të këtij sistemi të kapur nga interesat e ngushta”.

Koci, në cilësinë e përfaqësuesit të biznesit dhe anëtarit të Bordit të AKB-së, apeloi për mobilizim të përgjithshëm të institucioneve, shoqërisë civile dhe mediave, në mënyrë që korrupsioni të mos mbetet standard jetese, por të kthehet në çështje kombëtare për ta ndaluar dhe për ta luftuar me përkushtim e guxim.



Mbi 10 mijë euro të padeklaruara në Vërmicë, konfiskohet një pjesë e saj

PRIZREN, 6 TETOR - Në Pikën Kufitare Vermicë, gjatë një kontrolli të detajuar ndaj një automjeti që po hynte në territorin e Republikës së Kosovës, janë zbuluar mjete

monetare të padeklaruara. Pas pyetjes së zakonshme nga zyrtarët doganorë, udhëtari kishte deklaruar se nuk posedonte mjete monetare për deklarim. Megjithatë, pas

kontrollit të detajuar në vijën e dytë, u konstatua se ai posedonte mjete monetare që tejkalonin kufirin e lejuar prej 10,000 eurosh, pa bërë deklarimin paraprak.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë masat e parapara ligjore, ku është konfiskuar 25% e shumës së padeklaruar, ndërsa pjesa



Reagim i KMDLNj-së

PSE KAQ SHUMË REDUKTIME ME RRYMË?!

Kohëve të fundit janë shpeshtuar reduktimet e furnizimit me rrymë që zgjasin nga 10 deri në 13 orë. Reduktimet paralajmërohen në media ndonëse ka raste edhe kur nuk paralajmërohen. Arsyetimet janë kryesisht për shkak të prishjeve apo ndërhyrjes në rrjet por se është bërë thuaja rregull që reduktimet janë një herë në javë dhe kohëzgjatja është e njëjtë. KMDLNj-së i janë drejtuar qytetarë për të dëshmuar se gjatë këtyre reduktimeve të gjata po i dëmtohen pajisjet shtëpiake dhe të punës dhe se nga KESCO nuk hasin në mirëkuptim për kompensim të dëmeve sikur që ekipet intervenuese nuk dalin për të verifikuar dëmin material. Qytetarët i paguajnë me rregull

faturat e energjisë elektrike prandaj kërkojnë furnizim të rregullt me rrymë. Për dëmet në pajisje shtëpiake dhe mjete të punës qytetarët bëjnë përgjegjës operatorin për furnizim me rrymë shkaku i reduktimeve të gjata dhe furnizimit me rrymë të intensitetit më të ulët. Qytetarët dyshojnë se reduktimet e shpeshta dhe të gjata me rrymë nuk bëhen ekskluzivisht për shkak të prishjeve por shkaku se rryma i shitet vendeve tjera. KMDLNj rekomandon qytetarët që të padisin KESCO-n për dëmet duke kërkuar kompensimin e atyre dëmeve. Qytetarët janë paralajmëruar se në muajin dhjetor mund të ketë rishikim të çmimit të energjisë elektrike e që do të prekë shumë buxhetin familjar të shtresave



më të rrezikuara si pensionistët, kategoritë e dala nga lufta, personat me të ardhura më të vogla sikur edhe shumicën e bizneseve. Rishikimi përkatësisht rritja e çmimit të energjisë

elektrike në mënyrë zinxhirore do të rrisë çmimet e artikujve të domosdoshëm për mbijetesë sikur edhe të gjitha shërbimeve. KMDLNj fton qytetarët që në mënyrë të vendosur të

kundërshtojnë rritjen e çmimeve të energjisë elektrike duke përdorur të gjitha mjetet e lejuara. Kosova është në bllokadë institucionale dhe qytetarët po e paguajnë çmimin e papërgjegjshëm. Rritja e pagave janë në shpërputhje me shkallën e inflacionit, pensionet kanë vendnumëruar duke i vrarë për së gjalli pensionistët, kategoritë sociale janë varfëruar skajshëm, veteranët dhe invalidët e luftës po bëjnë vetëvrasje për shkak të kushteve të rënduara ekonomike. Prandaj, KMDLNj kërkon përgjegjshmëri nga përfaqësuesit e institucioneve që të sillen dhe veprojnë në përputhje me situatën duke themeluar institucionet në mënyrë që të krijohen kushte për tejkalim të situatës së rënduar.

LIDHJA E BIZNESEVE: PËR INATE POLITIKE PO DËMTOHET EKONOMIA E VENDIT, MBI 1 MILIARD EURO TË BLOKUARA NË KUVEND

PRISHTINË, 6 TETOR - Lidhja e Bizneseve të Kosovës nëpërmjet një reagimi të gjatë kanë shprehur ka shqetësimin për situatën e krijuar pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, ku sipas tyre, mungesa e institucioneve funksionale dhe vendimmarrjes e ka futur vendin në ngërç të plotë ekonomik. Sipas tyre për inate politike po dëmtohet ekonomia e vendit, investimet po bien ndërsa qytetarët dhe bizneset po e ndjejnë barrën e papërgjegjshësisë politike çdo ditë. “Për inate politike po dëmtohet ekonomia e vendit, ndërsa Kosova po përballlet me rritje të importit dhe ulje të eksportit, gjë që



thellon më tej bilancin negativ tregtar dhe dëmton konkurrueshmërinë e prodhimit vendor. Mungesa e reformave fiskale dhe pezullimi i politikave zhvillimore kanë

krijuar një klimë pasigurie në sektorin privat. Shumë borde dhe agjenci shtetërore kanë mbetur me ushtrues detyre, pa legjitimitet për të marrë vendime strategjike, duke

paralizuar proceset ekonomike”, thuhet në këtë reagim. Lidhja e Bizneseve, mes tjerash, thotë se mbi 1 miliard euro kredi dhe grante kanë mbetur të bllokuara në Kuvend teksa nuk lanë pa përmendur edhe çmimet e larta të energjisë elektrike dhe rritjen e kostos së prodhimit. “Mbi 1 miliard euro kredi dhe grante zhvillimore mbeten të bllokuara në Kuvend për shkak të mosfunksionimit institucional. Këto mjete, që do të mund të investoheshin në energji, infrastrukturë, arsim dhe prodhim, sot qëndrojnë të palëvizshme, ndërsa bizneset përballen me vështirësi të mëdha në terren. Kosova po

përballlet njëkohësisht me çmime të larta të energjisë dhe kosto të shtuara të prodhimit; mungesë investimesh të huaja dhe rreziku për largim të kapitalit ekzistues; ngadalësim të rritjes ekonomike dhe humbje të vendeve të punës; pezullim të dialogut strategjik Kosovë-ShBA, që dëmton rëndë imazhin dhe besueshmërinë ndërkombëtare të vendit”, thuhet në reagimin e Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, duke bërë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe zgjidhje urgjente të krizës politike, në mënyrë që vendi të rifitojë stabilitetin ekonomik dhe besimin e investorëve.

Murati tha se ka rritje të qarkullimit të bizneseve, reagon Rukiqi duke e quajtur “ekspert për gjithçka”

PRISHTINË, 6 TETOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se qarkullimi i bizneseve deri të fund të muajt gusht të këtij viti ka shënuar ngritje 10.06% më shumë se sa periudha e njëjtë në vitin e kaluar. Kështu ka shkruar Murati në një postim në rrjetin social “Facebook”. “Qarkullimi i bizneseve deri në fund të muajt gusht të këtij viti ka shënuar 15.2 miliardë euro, apo 10.06% më

shumë sesa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Dinamikë të ngjashme ka pasur edhe fitimi neto i bizneseve, i cili bazuar në deklaratimet e tatimit në fitim të korporatave del se ka shënuar rritje prej 9.45% krahasuar me vitin e kaluar”, ka theksuar Murati. Një reagim ndaj deklaratës së Muratit, e ka bërë Berat Rukiqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Sipas Rukiqit, rritja në qarkullim ka pasur vetëm të kompanive që merren me shitblerjen e energjisë elektrike. “Po, i nderuar ‘ekspert’ për gjithçka. E saktë është rritja e qarkullimit dhe fitimeve në kompanitë që merren me shitblerjen e energjisë elektrike, si pasojë e rritjes stratosferike të çmimeve të energjisë. Pyeti prodhuesit dhe bizneset në sektorë të tjerë nëse e kanë këtë rritje”, ka pohuar ai.



TONY I ARABISË

Nga Lufta në Irak te “Bordi i Paqes” në Gaza: Rikthimi i Blair-it në Lindjen e Mesme



Rachel SYLVESTER

Më 27 gusht, Donald Trump mblodhi këshilltarët më të lartë në Zyrën Ovale për të diskutuar krizën e përshkallëzuar në Gaza. Përkrah Steve Witkoff, të dërguarit të posaçëm amerikan për Lindjen e Mesme, dhe Jared Kushner, dhëndrit të presidentit, ishte ish-kryeministri britanik Tony Blair. Të tre i shpjeguan Trumpit se pa një zgjidhje të drejtë për Gazën, paqja në rajon do të mbetet e pamundur. Ata e lavdëruan duke i thënë se marrëdhëniet e tij me izraelitët dhe shtetet arabe e vendosnin në një pozitë unike për të arritur një marrëveshje historike. Trumpi u tregua i interesuar. Teksa ata i paraqitën “planin gjithëpërfshirës” për rindërtimin pas luftës në Gaza, ai i dëgjo me vëmendje. Burime të brendshme thonë se ky ishte momenti vendimtar kur presidenti hoqi dorë nga ideja e tij për të zhvendosur palestinezët në vende të tjera dhe për ta shndërruar Gazën në një “Rivierë amerikane të Lindjes së Mesme”. Ai ra dakord që SHBA të angazhohej për rindërtimin e Gazës, si pjesë e një marrëveshjeje më të gjerë rajonale. Vendosmëria e tij u forcua edhe më shumë dy javë më vonë, kur Izraeli bombardoi Katarin, një aleat kyç i SHBA-së. Si gjithmonë, motivet e Trumpit ishin më shumë personale se idealiste. “Do të bëjë çdo gjë nëse mendojnë se kjo i sjell Çmimin Nobel për Paqe,” tha një person që e njeh mirë. Një tjetër e përshkroi politikën e jashtme të tij me fjalët: “Pse të mos bëjmë të gjithë paqe, që të bëjmë të gjithë para?” Tani, gati dy vjet pas sulmeve të 7

tetorit ndaj Izraelit, rrotat diplomatike janë vënë sërish në lëvizje. Katër ditë pas publikimit të planit 20-pikësh të Trumpit për paqen në Gaza, Hamasi njoftoi se do të lironte pengjet izraelite. Edhe pse pranoi vetëm pjesërisht kushtet e planit, Trumpi vendosi ta pranojë dhe kërkoi që Izraeli të ndalonte “menjëherë” bombardimet. Ende ka shumë gjëra që mund të shkojnë keq, dhe vetë plani ka shumë të meta. Megjithatë, shpresat për fundin e luftës janë rritur. Një figurë e lartë laburiste mendon se Trumpi e ka kthyer papërshtueshmërinë e tij në një “armë diplomatike” të efektshme. Nëse plani presidencial do të zbatohet, Tony Blair do të luajë një rol qendror si anëtar i parë i emëruar i “Bordit Ndërkombëtar të Paqes”. Ai nuk ka ndërmend të jetë një figurë simbolike – “një emër në derë”, siç thotë vetë – por do të vendoset fizikisht në rajon dhe do të angazhohet drejtpërdrejt për sigurimin dhe menaxhimin e fondeve për rindërtimin e Gazës. Instituti i tij, Tony Blair Institute, ka tashmë gati 100 punonjës në Lindjen e Mesme. Synimi është që administrimi i përditshëm i Gazës të bëhet nga palestinezë, përmes një komiteti teknokratik dhe apolitik. Sipas deklaratës së Shtëpisë së Bardhë, qëllimi është “rindërtimi dhe gjallërimi i Gazës”, duke shfrytëzuar burimet financiare të rajonit dhe duke përfshirë ekspertë që kanë ndihmuar në krijimin e “qyteteve-mrekulli” të Lindjes së Mesme. Gjuha, siç vihet re, është ajo e një zhvilluesi të pasurive të paluajtshme – dhe Blair ka marrëdhënie të forta me investitorë në botën arabe dhe më

gjerë. Financimet do të vijnë nga vendet e BE-së, Norvegjia, SHBA, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Katari. Tetëmbëdhjetë vjet pasi la Downing Street, Blair ruan ende lidhje të fuqishme me liderët e rajonit – Mohammed bin Salman të Arabisë Saudite, Mohammed bin Zayed të Emirateve, Mbretin Abdullah të Jordanisë. Ai e njeh Benjamin Netanyahu që nga vitet 1990 dhe është shumë afër me Jared Kushnerin. Të dy u njohën në qarqet shoqërore të Manhatanit afro 20 vjet më parë dhe u rilidhën në 2010, gjatë pagëzimit të vajzave të Rupert Murdoch dhe Wendi Deng. Marrëdhënia u forcua më tej me ardhjen e Trumpit në pushtet në vitin 2016, kur Kushner u bë këshilltar i lartë i presidentit me përgjegjësi për Lindjen e Mesme. Në një konferencë më 2019, Kushner e quajti Blairin “mik të mirë dhe këshilltar me përvojë”, ndërsa një vit më vonë Blairi ndihmoi në afrimin e Emirateve të Bashkuara me Izraelin për Marrëveshjet e Abrahamit. Por përfshirja e tij është shumë e debatueshme, veçanërisht mes palestinezëve. Megjithëse ai ndihmoi në arritjen e paqes në Irlandën e Veriut, reputacioni i tij u njollos rëndë nga roli në Luftën e Irakut (2003). Ish-drejtori i Zyrës së Jashtme, Sir Simon Fraser, vëren se “Blairi gëzon besim në Uashington, Izrael dhe Gjirin Persik – por “rruga arabe” nuk e ka harruar Irakun.” Për të tjerë, ideja e një “Tony of Arabia” që zbrit në Lindjen e Mesme për të shpëtuar botën, ka një jehonë koloniale. Daniel Levy, president i US/Middle East Project, e quan planin e Trumpit “një kartel të stilit

Dutch East India Company të shekullit XXI.” Sipas tij, “kur palestinezët nuk menaxhojnë vetë asgjë, në ç’botë mund të funksionojë një model i tillë?” Salman Shaikh, ish-këshilltar i posaçëm i të dërguarit të OKB-së për Lindjen e Mesme, thotë se Blair është i besuar nga elitat, por “pa përfshirje reale palestineze, nuk ka drejtësi e as ekuilibër”. Megjithatë, të tjerë janë më optimistë. Sir Peter Ricketts, ish-shefi i Zyrës së Jashtme nën Blairin, mendon se ish-kryeministri ka patur “ndikim pozitiv” te Trumpi, duke mbajtur gjallë perspektivën e zgjidhjes me dy shtete. “Iraku është albatrosi rreth qafës së tij,” thotë ai, “por Blair ka mësuar nga gabimet e Irakut dhe tani sjell përvojën e çmuar të tranzicioneve pas konfliktit.” Në fakt, më 2007, ditën që la Downing Street, Blairi u emërua menjëherë i dërguar i posaçëm për Lindjen e Mesme nga Kuarteti (OKB, SHBA, BE dhe Rusia). Atëherë, Shtëpia e Bardhë paralajmëroi: “Ai nuk është Superman dhe nuk ka mantel.” Ai u vendos në hotelin American Colony në Jerusalem, ku zuri një kat të tërë, por roli i tij u kufizua kryesisht në zhvillimin ekonomik, pasi u pengua nga elementë të administratës amerikane. Për Blairin, që është një nga të paktët liderë perëndimorë që “beson në Zot”, beteja e vërtetë ka qenë gjithmonë ajo ekzistenciale mes Islamit dhe islamizmit, mes tolerancës fetare dhe ekstremizmit ideologjik. Tani ai shpreson që lidhja e tij me Kushnerin t’i sigurojë qasje direkte tek Trumpi. Ish-ministri konservator për Lindjen e Mesme, Alistair Burt, thotë se kritikën ndaj Blairit për bashkëpunimin me ta

janë të padrejta: “Janë të vetmit që kanë mundësi reale të arrijnë diçka. Duhet të punosh me ata që mund të bëjnë ndryshim.” Blairi ka pasur gjithmonë dëshirën për të zgjidhur probleme që askush tjetër nuk mund t’i zgjidhë. Sir David Manning, ish-këshilltar i tij për politikën e jashtme, kujton se pas përvojës në Irlandën e Veriut, Blairi besonte se “çdo çështje e pazgjidhshme, mund të zgjidhet.” Ndërsa pas 11 shtatorit, ai e pa konfliktin izraelito-palestinez si një nga shtysat kryesore të radikalizmit dhe terrorizmit që duhej trajtuar me çdo kusht. Sipas biografit Sir Anthony Seldon, Lindja e Mesme është “një çështje thellësisht personale për Blairin.” “Ajo vjen nga besimi i tij fetar dhe dëshira për t’u parë si një shërues – si dikush që ndërton ura, unifikon dhe ka guximin të hyjë në territore ku të tjerët nuk guxojnë.” Sir John Jenkins, ish-ambasador në disa vende të Lindjes së Mesme, thotë se për Blairi “ka shumë punë të pambyllura në rajon” – një punë që “nuk mund të përfundojë kurrë.” “S’do ta quaja mesianik, por ka një optimizëm të pashuar tek ai, që në mungesën e çdo shprese tjetër në politikën perëndimore, nuk është domosdoshmërisht gjë e keqe.” Në moshën 72-vjeçare, Blair nuk ka më asgjë për të humbur. Ai është shumë i pjekur për t’u manipuluar nga Trumpi, por e di se vetëm ai ka fuqinë për ta bërë planin e paqes realitet. Kur deputetët laburistë e pyesin si mund të punojë me një republikan si Trumpi, ai përgjigjet thjesht: “Nëse arrijmë të ndalim luftën, do të kemi bërë diçka të mirë.” / The Observer – Bota.al

SI PËRGJIGJE NDAJ MOSKËS, NATO DUHET T'I RIKTHEHET MANUALIT TË LUFTËS SË FTOHTË



Nga Sergey RADCHENKO

Muajin e kaluar, një tufë dronësh rusë shkelën kufijtë e Polonisë. Disa u rrëzuan. Pak ditë më vonë, një tjetër dron rus fluturoi mbi hapësirën ajrore të Rumanisë, drejt Ukrainës. Mbrojtja ajrore rumune e la të largohej. Pastaj, më 19 shtator, tre avionë rusë MiG-31 hynë në hapësirën ajrore të Estonisë. F-35 italiane – në mision të NATO-s në zonë – i interceptuan rusët dhe i shoqëruan jashtë.

Rusia e ka shkelur edhe më parë hapësirën ajrore të NATO-s, por shkalla e këtyre provokimeve të fundit i bëjnë ato të dallojnë nga të tjerat. Shkeljet do të marrin fund vetëm kur ndërhyrësit të rrëzohen. Për fat të mirë, rrëzimi herë pas here i një avioni luftarak rus – e aq më tepër i dronëve – nuk ka gjasa të çojë në përshkallëzim më të gjerë. Madje mund të ndihmojë në uljen e tensioneve, duke forcuar vijat e kuqe.

Lufta e Ftohtë ofron mësimë të rëndësishme për trajtimin e incidenteve të tilla. Edhe pse në kujtesën publike shpesh

mendohet se Lufta e Ftohtë “delegoi” luftimet në atë që sot e quajmë “jugu global”, ndërsa dy superfuqitë shmangën përplasjet e drejtpërdrejta ushtarake, në fakt nuk ka qenë krejt kështu.

Që nga vitet 1950 pati disa incidente ku avionë amerikanë u sulmuan nga interceptues sovjetikë. Më i famshmi ndodhi më 1 maj 1960, kur një U-2 i pilotuar nga Gary Powers u rrëzua mbi Sverdlovsk (sot Jekaterinburg), thellë në territorin sovjetik. Ishte një fitore propagandistike për BRSS. Jo vetëm që nuk pati kundërpërgjigje ushtarake nga SHBA, por presidenti i atëhershëm, Dwight D. Eisenhower, pezulloi përkohësisht dërgimin e U-2-ave të tjerë mbi hapësirën sovjetike, pasi u vlerësua shumë e rrezikshme.

Sovjetikët rrëzuan një tjetër U-2 mbi Kubë më 27 tetor 1962, një ditë që historianët e Luftës së Ftohtë e kujtojnë si “Të shtunën e zezë”. Edhe pse sot mund të duket si akt i pamend, ai ishte i tillë vetëm sepse ndodhi në kulmin e krizës së raketave në Kubë, kur bota iu qas Armagedonit. Ne nuk

jemi në një situatë të tillë.

As më 1 shtator 1983, kur sovjetikët rrëzuan një avion civil që kishte fluturuar gabimisht mbi territorin e tyre në Lindjen e Largët – incident që shkaktoi vdekjen e 269 pasagjerëve e anëtarëve të ekuipazhit, përfshirë një kongresmen amerikan – SHBA nuk iu përgjigj ushtarakisht.

Dikush mund të thotë se nuk pati kundërpërgjigje sepse amerikanët ishin më të kujdesshëm se sovjetikët. Në të vërtetë, të dyja palët ishin të kujdesshme dhe e kuptonin se ishte më e sigurt të uleshin tonet. NATO duhet t'i marrë këto mësimë seriozisht. Rrëzimi i avionëve rusë që shkelin hapësirën ajrore nuk është hap drejt luftës. Është një masë parandaluese e domosdoshme për të ruajtur besueshmërinë përballë provokimeve të kundërshtarit. Të dyja palët angazhohen në operacione psikologjike për të testuar vendosmërinë e tjetrit. Nëse shkelësit nuk marrin një mësim në kohë, do të konkludojnë se vijat e kuqe janë fiktive dhe mund të shkelen pa pasoja – çka do të

çojë vetëm në situata edhe më të rrezikshme, teksa kundërshtari shtyn gjithnjë e më tej.


Ekzistojnë protokolle për trajtimin e ndërhyrjes së avionëve të armikut. Edhe në kulmin e Luftës së Ftohtë, dy palët gjenin mënyra për të komunikuar.

Teksa SHBA fillon një tërheqje strategjike nga Evropa, u takon evropianëve të mësojnë të flasin me rusët, përfshirë edhe përmes kontakteve ushtar-me-ushtar. Për çdo orë deklaratash të zjarra publike (në të cilat evropianët janë vërtet ekspertë), duhet të ketë tre orë diplomaci të qetë, prapa dyerve të mbyllura. Por kur diplomacia dështon, duhet përdorur forca. Kur shkelësit nuk përgjigjen, e vetmja përgjigje e arsyeshme është t'i rrëzosh. Dhe nuk duhet të kemi asnjë iluzion se pikërisht këtë do të bënin rusët, nëse avionët tanë do të depërtonin në hapësirën e tyre ajrore.

Rrëzime të tilla mund të sjellin shkurtimisht një rritje tensionesh. Kjo ndodhi, për shembull, më 24 nëntor 2015, kur ushtria turke rrëzoi një bombardues rus, që kishte shkelur hapësirën e saj ajrore. Reagimi fillestar i rusëve

ishte militant dhe ata vendosën sanksione ndaj Turqisë. Por më vonë, Vladimir Putini zgjodhi ta linte pas këtë episod dhe të përqafohej politikisht me presidentin turk, Recep Tayyip Erdoğan. Ndihmoi edhe fakti që ky i fundit shprehu keqardhje. Të dyja palët e kuptuan se ulja e tensioneve i shërbente interesave të tyre. Që atëherë, rusët janë përmbajtur nga provokimet ushtarake ndaj Turqisë – një tregues i qartë i aftësisë së pavullnetshme të Kremlinit për të nxjerrë mësimë.

Putini do të vazhdojë të testojë kufijtë e të lejueshmes. Ai synon të poshtërojë NATO-n dhe të thellojë ndarjet në përfundim duke ekspozuar fërkimet mes vendeve në krahun lindor, që rrezikohen drejtpërdrejt nga provokimet e tij, dhe aleatëve më me fat – si italianët, francezët dhe britanikët – të cilët, të paktën për tani, mund të mbajnë një qëndrim më të qetë. Megjithatë, këta të fundit kanë stacionuar avionë luftarakë në zonë, dhe pikërisht këta avionë do të duhet të përdoren për t'i dhënë Putinit mësimin e duhur. / në shqip nga bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Presidenti i FIFA-s nesër vjen në Prishtinë

Presidenti i FIFA-së, shtëpisë botërore të futbollit, Gianni Infantino do ta vizitojë nesër (e mërkurë) Kosovën. Gjatë vizitës

së tij, kreu i FIFA-s do të pritët nga krerët e lartë institucionale në Kosovë, ndërsa nga ora 13:00, ai do të dekorohet nga presidentja e

Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Në një ceremoni zyrtare në hotelin “Emerald”, Infantino do të dekorohet për kontributin e

FIFA-s në pranimin e futbollit të Kosovës dhe ndihmën e zhvillimin për futbollin e futbollistët.



FRANCO FODA, OPTIMIST PARA NDESHJEVE ME SLOVENINË DHE SUEDINË

PRISHTINË, 6 TETOR - Trajneri i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, ka mbajtur të hënën një konferencë për medie në prag të dy ndeshjeve të tetorit, kundër Sllovenisë këtë të premte dhe ndaj Suedisë të hënën që vjen. Foda është shprehur optimist për përballjet e këtij muaji, sidomos për atë ndaj sllovenëve në stadiumin “Fadil Vokrri”. “Do të jenë dy ndeshje të vështira, jo të lehta, por meqenëse kemi fituar ndaj Suedisë, ekipi ka treguar se ka kapacitetet, pasion dhe vendosmëri. Skuadra e ka parë që mund të fitojë edhe kundër kundërshtarëve të tillë. Sllovenia është shumë e fortë, shumë e fuqishme, ka përvojë të hatashme, mbrojtje dhe sulm mjaft të mirë. Ne do të ushtrijmë sa më mirë dhe të përgatitemi sa më mirë për ndeshjet e radhës. Në shtëpi kemi mundësi më të mëdha pasi luajmë përpara tifozëve tanë të zjarrtë dhe shpresojmë që të jemi të gatshëm të triumfojmë. Pas fitores ndaj Suedisë e kemi fituar vetëbesimin dhe ndaj Sllovenisë pres angazhim maksimal nga lojtarët”, ka thënë Foda.

Në këtë kontekst, Foda nuk e ka fshehur ëndrrën për ta kualifikuar Kosovën në Botëror, sidomos pas fitores dhe paraqitjes së madhe ndaj suedezëve. “Të gjithë besojmë që mund ta arrijmë së paku vendin e dytë. E kam potencuar se duhet të paraqitemi si ekip dhe i kemi këto emocione. Por, për ta arritur vendin e dytë duhet të luajmë si ndaj Suedisë. Duhet ta kemi një shpirt ekipor. Është një grup i vështirë, por tash edhe ekipi beson se mund të kualifikohemi tutje dhe kjo është mjaft e rëndësishme”, ka thënë Foda.

Në këtë konferencë, Foda ka folur për mungesën e Amir Rrahmanit shkaku i lëndimit dhe për prurjen më të re, Albjan Hajdari, i cili ka hequr dorë nga përfaqësimi i Zvicrës për t’iu bashkuar “Dardanëve”. Ai ka thënë se Rrahmani nuk është i rëndësishëm për Kombëtaren vetëm në fushë, por edhe jashtë saj. “Sigurisht që Amir Rrahmani është shumë e vështirë të zëvendësohet. Por, kundër Suedisë e kemi treguar që të gjithë lojtarët janë të rëndësishëm dhe që mund të



zëvendësohet edhe një lojtar si Rrahmani. Amir Rrahmani nuk është i rëndësishëm vetëm në fushë, por edhe jashtë saj sepse është lider. Tash e kemi edhe Albjan Hajdarin që fatmirësisht ka vendosur që t’i bashkohet Kosovës. Gjatë këtyre ditëve do ta shohim qartë se kush në çfarë gjendje është dhe nëse do të jetë apo jo Hajdari në formacionin startues”, ka thënë Foda. Po ashtu, Foda ka folur për rikthimin e madh të Edon Zhegrovës, i cili i ka munguar Kombëtares për një kohë të

gjatë shkaku i lëndimit. “Më e rëndësishmja është që Edoni e ka gjetur një ekip të ri, Juventusin. Dhe, e rëndësishme është që është i gatshëm dhe në dispozicion për të luajtur për Kosovën. Të gjitha gjërat do t’i diskutoj me Edonin, por edhe me lojtarët tjerë. I kemi katër ditë në dispozicion për ta parë gjendjen e ekipit dhe se kush do të jetë në formacionin startues”, ka thënë Foda.

Sekretori i Kosovës është pyetur nga gazetarët edhe për mungesën e ftesës së Bersant

Celinës dhe Emir Sahitit, të cilët kanë munguar edhe në grumbullimin e shtatorit. “Me Celinën e kam pasur një bisedë shumë të këndshme. Celina është i gatshëm të rikthehet dhe ta përfaqësojë Kosovën. I kam thënë se nëse do të vazhdojë të ketë paraqitje të mirë, ka mundësi të ftohet në ekip. Për momentin e kemi një ekip të mirë dhe i gatshëm për ndeshjet e radhës. Kurse tek Emir Sahiti gjendja është paksa më ndryshe. Unë e kam lexuar prononcimin e tij për medie dhe çka është për mua më e rëndësishmja, unë nuk e pranoj kur një lojtar flet indirekt keq për lojtarët tjerë. Kjo për mua është e papranueshme, secili lojtar mund t’i ketë pakënaqësitë e tij se a luan apo jo, por të shohim më të ardhmen. Më duhet ta potencoj se nuk e kam asnjë problem personal me asnjë trajner, por që lojtarët duhet t’i pranojnë zgjedhjet e trajnerit. I kemi afërsisht 40 lojtarë dhe të gjithë ata që i pranojnë vendimet e trajnerit, do t’i ftoj për zemërsisht”, ka përfunduar Foda.

PRISHTINA BLINDON POZITËN PARË NË SUPERLIGË



PRISHTINË, 6 TETOR - Në kuadër të javës së tetë të AlbiMall Superligës së Kosovës në futboll Prishtina dhe Llapi kanë arritur fitore të rëndësishme. Në derbin e javës, të zhvilluar në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, Prishtina ka triumfuar ndaj Ballkanit, me rezultat 1:0. Me këtë fitore, Prishtina ka forcuar pozitën e parë në renditje, me 19 pikë, derisa Ballkani ka mbetur i dyti, me katër pikë më pak. Ndërkohë, në ndeshjen tjetër të zhvilluar në stadiumin “Liman Gegaj” në

Malishevë, skuadra e Llapit ka shënuar fitore me përmbysje rezultati ndaj Malishevës, me shifrat 2:1. Kjo ishte fitorja e dytë radhazi për Llapin, që tani ka 9 pikë dhe renditet në vendin e gjashtë të tabelës, ndërsa Malisheva mbetet me 10 pikë në pozitën e pestë. Po ashtu në xhiron e tetë, Ferizaj ka arritur të rikthehet te fitorja pas pesë humbjeve rresht, ndërsa përballja në mes të Dukagjinit dhe Prishtinës së Re ka përfunduar pa fitues. Në ndeshjen e zhvilluar në Ferizaj,

skuadra vendase ka triumfuar ndaj Drenicës, me rezultat 2:0. Pas kësaj fitoreje, skuadra ferizajase është ngjitur në pozitën e shtatë të tabelës me 9 pikë, ndërsa Drenica mbetet në vendin e katërt me 11 pikë. Ndërkohë, në Klinë, ndeshja në mes të Dukagjinit dhe Prishtinës së Re, e zhvilluar në stadiumin “18 Qershori”, ka përfunduar me barazim 1:1. Pas këtij barazimi, Dukagjini ruan pozitën e tretë me 14 pikë, ndërsa Prishtina e Re renditet në vendin e tetë me 7 pikë.

Guardiola me 250 fitore në Ligën Premier, trajneri më i shpejtë që e arrin këtë rekord

MANCHESTER, 6 TETOR - Pep Guardiola ka shtuar një tjetër arritje historike në karrierën e tij të lavdishme, pasi me fitoren 1-0 ndaj Brentford të dielën në “Gtech Community Stadium” është bërë

trajneri më i shpejtë që arrin 250 fitore në Ligën Premier. Tekniku katalanas e ka arritur këtë shifër të jashtëzakonshme pas vetëm 349 ndeshjesh në krye të Manchester Cityt, duke vendosur

një rekord të ri që thekson dominimin e tij në futbollin anglez që prej vitit 2016. Për krahasim, legjendës së Manchester Unitedit Sir Alex Ferguson i janë dashur 404

ndeshje për të arritur 250 fitore, ndërsa ish-trajneri i Arsenalit Arsène Wenger e ka arritur këtë shifër pas 423 ndeshjesh, çfarë e bën suksesin e Guardiols edhe më mbresëlënës.





CONTRACT NOTICE

SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurementof the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 06/10/2025

Procurement No	Mentoring	001	2025	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English x

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society “Mother Teresa”		
Postal address: str. Mujë Krasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code:10000	Country: Kosovo
Contact point(s):Zef Shala		Telephone:038-542-865
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-869
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:
External service provider for provision of Mentoring & Coaching to 50 beneficiaries

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Chooseone category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

		X Services
--	--	------------

II.1.5) Short description of the object of the contract
External service provider for provision of Mentoring & Coaching to 50 beneficiaries

II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)
93.000.000.-8

II.1.7) Variants are accepted
No x

II.1.8) Division into lots
NO x

External service provider for provision of Mentoring & Coaching to 50 beneficiaries

II.1.11) Estimated contract value: Approximately 38,000.00

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 4 month (from the contract signature) or
Starting 01/12/2025
Completion 15/03/2026

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No ☒

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements:
1. Certificate of Business Registration
2. Fiscal Number Registration
3. VAT-Certificate if applicable
Documentary evidence required
Copy of documentary

III.2.2) Professional Suitability:
1.Business Registration Certificate
2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3 References of previous experience in similar projects
Documentary evidence required:
Copy of prove documents

III.2.3) Economic and financial capacity
1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only)
2. Certificate from Justice that’s Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only)
3. Company profile
Documentary evidence required:
Copy of documentary

III.2.4) Technical and professional capacity
1.Business Registration Certificate
2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3 References of previous experience in similar projects
Documentary evidence required:
Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No ☒
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes ☒

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure
Open

IV.2) AWARD CRITERIA
Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No ☒
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tenderdossier: date 13/10/2025 Payable documents No ☒	
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Date 06/11/2025 time 14:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders ☒ no	
IV.3.5) Is tender security needed:	No ☒
IV.3.6) Tender validity period: date: 06/11/2025 days 30 or months1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 06/11/2025 time 14:30 place Prishtina	


SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092,at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjend Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Furrës së bukës.

- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- “Fire Protection Agency Rifel Action” LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12.13.si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



100% Fresh & Natural

2%

2,8%

18% yndyrë

800g



TRADITË QË NGA 1992

